

VENDIM
Nr. 799, datë 12.10.2020

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE, TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR MAQELLARË-PESHKOPI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik të pronarëve, të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i segmentit rrugor Maqellarë - Peshkopi”.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen për pasuritë e llojit “tokë arë” dhe kultura bujqësore “drufrutorë”, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me një vlerë të përgjithshme prej 1 198 195 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë e llojit “tokë arë” dhe kultura bujqësore “drufrutorë”, me vlerë 1 198 195 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë, do të përballohet nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.
 5. Shpenzimet procedural, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
 6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Dibër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
 9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Dibër, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuara.
 11. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Dibër për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“MAQELLARË-PESHKOPI”

VLERËSIMI I PASURISË SË LLOJIT “TOKË ARË”, ËSHTË KRYER BAZUAR NË VKM-në NR. 89, DATË 3.2.2016
VLERËSIMI I KULTURAVE BUJQËSORE E DRUFROTORE ËSHTË KRYER BAZUAR NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 5.10.2000, I MINISTRISË SË
BUJQËSISË DHE USHQIMIT

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	Z.K.	Nr. i pasurisë	Sip. totale m ²	Sip. e shpronësuar m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e tokës arë në lekë	Kultura bujqësore Vlera në Lekë	Vlera totale në lekë	Adresa	Shënime
1	Ramadan Dine Koreni	Tokë arë	2940	144/2	2375	1	115	115		115	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Agush Dine Koreni	Tokë arë	2940	152	5750	1715	115	197225	304091	501316	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Nuredin Emin Kërçishta	Tokë arë	2940	161/2	1250	371	115	42665	133040	175705	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Myfit Haxhi Xhari	Tokë arë	2940	161/4	1000	227	115	26105		26105	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Qemal Tofik Xhari	Tokë arë	2940	193/1	2000	693	115	79695	212210	291905	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Lavdrim Rushit Isaku	Tokë arë	2940	162/3	1500	31	115	3565		3565	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	Ismet Rushit Isaku	Tokë arë	2940	162/2	1600	26	115	2990	2259	5249	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Nuredin Emin Kërçishta	Tokë arë	2940	200	2000	826	115	94990		94990	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Baudin Tosum Spahiu	Tokë arë	2940	205	3125	863	115	99245		99245	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
VLERA TOTALE						4753		546595	651600	1198195		